



# FLETORJA ZYRTARE

## E

### REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr. 79**

**2003**

**Shtator**

#### P Ë R M B A J T J A

Faqe

|                                       |                                                                                                                                                                                                                                                     |      |
|---------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Ligj nr.9127<br>datë 29.7.2003        | Për disa shtesa në ligjin nr.8810, datë 17.5.2001 "Për<br>përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së<br>privatizimit të shoqërisë anonime "ALBTELECOM".....                                                                              | 3527 |
| Ligj nr.9133<br>datë 11.9.2003        | Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së<br>Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të<br>Bashkuara të Amerikës për programin e Korpusit të Paqes<br>të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e<br>Shqipërisë”..... | 3528 |
| Vendim i KM<br>nr.589, datë 28.8.2003 | Për ngritjen dhe vënien në funksionim të qendrës pritëse të<br>viktimave të trafikut.....                                                                                                                                                           | 3530 |
| Vendim i KM<br>nr.590, datë 28.8.2003 | Për rritjen e pagesës kalimtare të ushtarakëve në rezervë<br>(lirim)                                                                                                                                                                                | 3532 |
| Vendim i KM<br>nr.592, datë 28.8.2003 | Për dhënien me koncesion të uzinës së telave e kabllave<br>Shkodër dhe për përcaktimin e kritereve të vlerësimit të<br>ofertave për marrjen me koncesion të këtij<br>objekti.....                                                                   | 3533 |

|                                              |                                                                                                                                                                                                                                                              |      |
|----------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.593, datë 28.8.2003        | Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion, të formës "ROT" të TEC-it të Kombinatit Energjetik sh.a., në Elbasan.....                                                                                                                                 | 3533 |
| Vendim i KM<br>nr.594, datë 28.8.2003        | Për miratimin e Marrëveshjes së koncesionit, të formës "ROT" ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Shoqërisë "Kurum International" sh.p.k., Tiranë për fabrikën e oksigjenit në Elbasan.....                 | 3534 |
| Vendim i KM<br>nr.596, datë 28.8.2003        | Për miratimin e kuotës së pranimit të studentëve në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari" për vitin akademik 2003-2004.....                                                                                                                                 | 3543 |
| Udhëzim i MASH dhe MPÇS nr.6, datë 14.3.2003 | Për regjistrimin e institucioneve të AFP-së.....                                                                                                                                                                                                             | 3544 |
| Udhëzim i MASH dhe MPÇS nr.17, datë 1.9.2003 | Për përbërjen, organizimin dhe funksionet e Komisionit të akreditimit të arsimit dhe formimit profesional.....                                                                                                                                               | 3544 |
| Udhëzim i MPÇS nr.437, datë 3.3.2003         | Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional.....                                                                                                                                                                 | 3547 |
| Udhëzim i MPÇS, ME dhe MTT                   | Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003 "Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i modernizimit të Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror, sh.a.".....                                                     | 3547 |
| Udhëzim i KQZ nr.6, datë 5.9.2003            | Për mënyrën e ngritjes dhe caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit.....                                                                                                                                                                               | 3549 |
| Udhëzim i KQZ nr.7, datë 13.9.2003           | Për emërimin e anëtarëve, kryetarit, zv/kryetarit dhe sekretarit të KQV-së.....                                                                                                                                                                              | 3551 |
| Udhëzim i KQZ nr.8, datë 15.9.2003           | Mbi procedurat ankimore-administrative të vendimeve të komisioneve zgjedhore të qeverisjes vendore.....                                                                                                                                                      | 3553 |
| Udhëzim i KQZ                                | Për një ndryshim në udhëzimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1, datë 11.7.2003 "Mbi procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2003", ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 25.7.2003..... | 3558 |
| Vendim i KKRT nr.168, datë 3.9.2003          | Për dhënie licence për radio vendore private "SHQIP" .....                                                                                                                                                                                                   | 3559 |

|                                        |                                                                                        |      |
|----------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KKRT<br>nr.169, datë 3.9.2003 | Për dhënie licence për radio vendore private "RADIO+3" ...                             | 3559 |
| Vendim i KKRT<br>nr.170, datë 3.9.2003 | Për dhënie licence për radio vendore private "REAL" ...                                | 3560 |
| Vendim i KKRT<br>nr.171, datë 3.9.2003 | Për dhënie licence për radio vendore private "ALDO-03<br>FM"                           | 3560 |
| Vendim i KKRT<br>nr.172, datë 3.9.2003 | Për dhënie licence për radio vendore private "EURO STAR<br>MUSIC" .....                | 3561 |
| Vendim i KKRT<br>nr.173, datë 3.9.2003 | Për dhënie licence për radio vendore private "NEW<br>PLANET"                           | 3561 |
| Vendim i KKRT<br>nr.174, datë 3.9.2003 | Për dhënie licence për radio vendore private "HOUSE OF<br>ARTS" .....                  | 3562 |
|                                        | Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur<br>të shtetasi Jazi Uku..... | 3562 |
|                                        | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Selam<br>Banaj.....                      | 3562 |
|                                        | Ndreqje gabimi.....                                                                    | 3563 |

**L I G J**  
**Nr.9127, datë 29.7.2003**

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.8810, DATË 17.5.2001 "PËR PËRCAKTIMIN E  
FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË  
ANONIME "ALBTELECOM""**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8810, datë 17.5.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom", bëhen këto shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 1, pas paragrafit të dytë shtohen tre paragrafë me këtë përmbajtje:

"Albtelecom" sha i jepet licencë për ofrimin e shërbimit publik telefonik të lëvizshëm, tokësor, sipas standardit GSM, nëpërmjet shoqërisë së re të krijuar, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Licenca jepet me kusht që:

- a) sigurimi i shërbimit të bëhet i bazuar në brezat e frekuencave 900 dhe 1800 MHz;
- b) ofrimi i shërbimit të fillojë jo më vonë se 12 muaj nga marrja e licencës;
- c) ofrimi i shërbimit të bëhet nga një shoqëri e re, ku "Albtelecom" sha të zotërojë 100 për qind të aksioneve. Kjo shoqëri të lidhë një marrëveshje, në kushte të barabarta, me "Albtelecom" sha, si operatorët e tjerë në treg.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, në zbatim të kushteve të parashikuara në paragrafin e mësipërm, të nenit 52 dhe të neneve vijuese të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", bën lëshimin, ndryshimin ose heqjen e licencës së lëshuar shoqërisë së re, përmendur në paragrafin e mësipërm."

**Neni 2**

Në pikën 1 të nenit 2, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Pjesë e paketës së shitjes së "Albtelecom" sha të jetë dhe shoqëria e re që do të ofrojë shërbimin publik telefonik të lëvizshëm, tokësor, ku partnerit strategjik do t'i ofrohen jo më pak se 51 për qind, por jo më shumë se 76 për qind e aksioneve të kësaj shoqërie."

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.3934, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Alfred Moisiu**

**L I G J**  
**Nr.9133, datë 11.9.2003**

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË**

**SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR  
PROGRAMIN E KORPUSIT TË PAQES TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e Korpusit të Paqes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3965, datë 19.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË  
BASHKUARA TË AMERIKËS NË LIDHJE ME PROGRAMIN E KORPUSIT TË PAQES NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës duke njohur rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të ndërsjellë e të dobishëm mes vendeve të tyre, kanë rënë dakord si vijon:

**Neni 1**

1. Qeveria e Shteteve të Bashkuara do të ofrojë vullnetarë të Korpusit të Paqes, ashtu siç mund të kërkojë Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe të aprovuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara për të kryer detyra në Shqipëri, për të cilat është rënë dakord reciprokisht.
2. Vullnetarët do të punojnë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të organizatave qeveritare dhe private në Shqipëri, të përcaktuara nga të dyja qeveritë.
3. Qeveria e Shteteve të Bashkuara do të ofrojë trajnim për t'i aftësuar vullnetarët që të realizojnë detyrat e tyre në mënyrën më efektive.
4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përballojë pjesë të kostos së programit të Korpusit të Paqes në Shqipëri, siç do të mund të bihet dakord ndërmjet të dyja qeverive.

**Neni 2**

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'u akordojë trajtim të barabartë vullnetarëve dhe personelit, të cilët kryejnë funksione me kontratë për Korpusin e Paqes dhe personave të varur prej tyre dhe pronës së tyre; do t'u akordojë atyre dhe pronës së tyre ndihmë dhe mbrojtje të plotë, përfshirë trajtim të barabartë ose më të mirë sesa ai që u akordohet shtetasve të Shteteve të Bashkuara, të cilët janë rezidentë të Shqipërisë, si dhe do të informojë, do të konsultohet dhe do të bashkëpunojë plotësisht me përfaqësues të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në lidhje me të gjitha çështjet që kanë

të bëjnë me ta.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i përjashtojë vullnetarët dhe personat që kryejnë funksione të kontraktuara me Korpusin e Paqes, të cilët nuk janë qytetarë apo rezidentë të përhershëm të Shqipërisë, nga të gjitha taksat ndaj pagesave që ata marrin për të përballuar koston e tyre të jetesës, si dhe ndaj të ardhurave të marra për punën e tyre me Korpusin e Paqes dhe të ardhurat e marra nga burime të tjera jashtë Shqipërisë; nga të gjitha tarifatat doganore dhe pagesa të tjera mbi pronën personale që sillet në Shqipëri për t'u përdorur prej tyre, si dhe nga të gjitha taksat e tjera dhe pagesat (përfshi taksën e vizave/emigracionit), përveç taksave për licencat. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të japë lejeqëndrimi dhe viza (përfshi viza me shumë hyrje-dalje), pa pagesë ose detyrime të tjera, për vullnetarët dhe personat, të cilët kryejnë funksione me kontratë për Korpusin e Paqes.

### Neni 3

1. Qeveria e Shteteve të Bashkuara do t'i pajisë vullnetarët, përfaqësuesin e Korpusit të Paqes dhe stafin e përfaqësuesit, me sasi të kufizuara pajisjesh dhe furnizimesh të cilat mund të konsiderohen të nevojshme nga të dyja qeveritë për të bërë të mundur që vullnetarët të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë efektive.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përjashtojë nga të gjitha taksat (përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar), detyrimet doganore dhe detyrime të tjera, të gjitha pajisjet, furnizimet dhe mallrat e shërbimet e tjera që janë sjellë ose janë blerë në Shqipëri nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara ose çdo kontraktues që financohet prej saj, për përdorimin e parashikuar në këtë Marrëveshje.

### Neni 4

1. Për të mundësuar Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të pranojë një përfaqësues të Korpusit të Paqes dhe stafin e këtij përfaqësuesi (përfshirë të punësuarit dhe personelin me kontratë të caktuar nga përfaqësuesi i Korpusit të Paqes) dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët do të bashkëjetojnë me ta siç do të jenë të pranueshëm për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Pavarësisht nga dispozita e ndonjë marrëveshjeje tjetër, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i përjashtojë këta persona dhe anëtarët e familjeve të tyre, me të cilët bashkëjetojnë dhe të cilët nuk janë nënshettas apo rezidentë të përhershëm të Shqipërisë, nga të gjitha taksat mbi të ardhurat e përfituara nga puna e tyre për Korpusin e Paqes apo burime të tjera jashtë Shqipërisë, nga të gjitha tarifatat doganore dhe pagesa të tjera mbi pronën e tyre personale të sjellë në Shqipëri për përdorimin e tyre dhe nga të gjitha taksat apo pagesat e tjera (përfshi taksën e vizave/emigracionit), përveç tarifave për licencat. Po kështu, këtyre personave dhe anëtarëve të familjeve të tyre, me të cilët bashkëjetojnë, do t'u akordohet status i njëjtit me atë që i akordohet stafit të personelit administrativ dhe teknik të misionit diplomatik të Shteteve të Bashkuara, me përjashtimin që nuk do t'u akordohen imunitetet.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të japë lejeqëndrimi dhe viza (përfshi viza me shumë kalime), pa taksa apo pagesa të tjera, për përfaqësuesin e Korpusit të Paqes, stafin dhe individët që kryejnë funksione në bazë të kësaj Marrëveshjeje, si dhe për anëtarët e familjeve të tyre me të cilët bashkëjetojnë.

### Neni 5

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përjashtojë nga kërkesat për depozitim dhe nga kontrolli valutor të gjitha fondet e futura në Shqipëri për përdorim, në përputhje me këtë Marrëveshje, nga ana e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara ose kontraktorëve të financuar prej saj. Fonde të tilla do të jenë të konvertueshme në valutën e Shqipërisë, në vlerën më të lartë që nuk është e jashtëligjshme në Shqipëri dhe nuk do t'u nënshtrohen kërkesave që ato të investohen.

## Neni 6

1. Përfaqësues të autorizuar të të dyja qeverive mund të bëjnë herë pas here rregullime për vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe programet e Korpusit të Paqes në Shqipëri, siç mund të paraqitet e nevojshme ose e dëshirueshme, me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo diskutim që mund të rrjedhë nga kjo Marrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore nga të dyja qeveritë.

## Neni 7

Pjesëmarrjet e secilës qeveri të përmendur këtu varen nga fondet në dispozicion.

## Neni 8

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet kohë pas kohe me pëlqimin e përbashkët të të dyja qeverive. Çdo amendament i tillë do të jetë me shkrim. Në rast të një konflikti ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe një marrëveshjeje të ardhshme në lidhje me bashkëpunimin për lehtësimin e asistencës, kjo Marrëveshje do të mbizotërojë përsa i përket programit të Korpusit të Paqes.

## Neni 9

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas shkëmbimit të notave që do të konfirmojnë se secila palë ka përfunduar procedurat e nevojshme të legjislacionit të brendshëm për hyrjen e Marrëveshjes në fuqi. Marrëveshja do të qëndrojë në fuqi deri nëntëdhjetë ditë pas datës së lajmërimit me shkrim të njërit prej qeverive drejtuar tjetrës me synimin për dhënien fund të Marrëveshjes. Kjo Marrëveshje mbizotëron mbi Marrëveshjen e 19 nëntorit 1991 "Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në lidhje me programin e Korpusit të Paqes të Shteteve të Bashkuara në Republikën e Shqipërisë", e cila do të marrë fund me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Përfunduar në Tiranë, Shqipëri më datë 22 korrik 2003, në dy kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, duke qenë të dyja tekstet utentike.

## **V E N D I M** **Nr.589, datë 28.8.2003**

### **PËR NGRITJEN DHE VËNIEN NË FUNKSIONIM TË QENDRËS PRITËSE TË VIKTIMAVE TË TRAFIKUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 10 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003" të shkronjës "e" të nenit 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

## **V E N D O S I:**

1. Ngritjen dhe vënien në funksionim të qendrës pritëse të viktimave të trafikut (që më poshtë do të përdoret qendra) në Linzë Tiranë.

2. Objekti ku do të vendoset qendra, i cili është në administrim të Ministrisë së Rendit Publik,

i kalon në administrim Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Me përfundimin e veprimtarisë së qendrës, objekti i rikthehet në administrim Ministrisë së Rendit Publik.

3. Në qendër të trajtohen viktimat e trafikut, shqiptarë dhe të huaj, si gra, vajza, fëmijë dhe emigrantë klandestinë, që kalojnë përmes Shqipërisë.

4. Ruajtja dhe siguri i qendrës të bëhet nga Ministria e Rendit Publik, sipas marrëveshjes që do të nënshkruhet ndërmjet saj dhe Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.

5. Struktura e qendrës, si institucion i përkujdesit shoqëror, në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, miratohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.

6. Për funksionimin e qendrës, Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, me vendimin nr.96, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin për vitin 2003 të numrit të punonjësve të institucioneve buxhetore", i shtohen 22 (njëzet e dy) punonjës.

7. Pagat e punonjësve të kualifikuar të qendrës përcaktohen sipas lidhjes II/M "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar" të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave.

8. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", shtohet lidhja II/33 "Niveli i pagave për punonjësit e qendrës pritëse të viktimave të trafikut", e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale. Shpenzimet për investime, që arrijnë vlerën 13 400 000 (trembëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë, të përballohen nga rialokimi i kostos lokale të projektit "Shpërndarja e shërbimeve sociale", ndërsa pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative dhe për mirëmbajtje, që arrijnë shumën 11 600 000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të përballohen nga rialokimi i fondeve të pagesës së papunësisë.

10. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**

| Nr. | Emërtimi i punonjësit           | Klasa | Shtesë për funksion |
|-----|---------------------------------|-------|---------------------|
| 1   | Drejtor                         | X     | 6                   |
| 2   | Përgjegjës sektori/kryetar dege | IX    | 5                   |
| 3   | Punonjës social                 | IX    |                     |
| 4   | Asistent social                 | VIII  |                     |
| 5   | Shofer                          | IV    |                     |
| 6   | Mirëmbajtës objekti             | IV    |                     |
| 7   | Magaziniar                      | IV    |                     |
| 7   | Kuzhinier                       | III   |                     |
| 8   | Punonjës lavanterie             | III   |                     |
| 9   | Ndihmëskuzhinier                | II    |                     |
| 10  | Pastrues                        | I     |                     |

Shënim: Këta punonjës përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune sipas përcaktimit të bërë në pikën 22 të lidhjes II-A, kreu II "Shtesa të tjera" të këtij vendimi.

**V E N D I M**  
**Nr.590, datë 28.8.2003**

**PËR RITJEN E PAGESËS KALIMTARE TË USHTARAKËVE NË REZERVË (LIRIM)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 dhe 21 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar", i ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Rritjen në masën 10 për qind të pagesës kalimtare që përfiton ushtaraku në rezervë (lirim) të caktuar deri më datë 1.7.2003, në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar", i ndryshuar.

2. Nga rritja përfitojnë ushtarakët e nxjerrë në rezervë (lirim) nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit.

3. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar përkatësisht për Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Rendit Publik dhe Shërbimin Informativ të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2003.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**V E N D I M**  
**Nr.592, datë 28.8.2003**

**PËR DHËNIEN ME KONCESION TË UZINËS SË TELAVE E KABLLOVE SHKODËR DHE  
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR MARRJEN  
ME KONCESION TË KËTIJ OBJEKTI**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Fillimin e procedurave për dhënie me koncesion të uzinës së telave e kablllove në Shkodër.  
2. Koncesioni të jetë i formës "ROT" (rehabilitim-operim-transferim).  
3. Organi shtetëror i autorizuar për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të jenë Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës.

4. Organi shtetëror të ngrejë grupin e punës, i cili të shqyrtojë ofertat e paraqitura, sipas kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- Vlera e investimit 40 pikë
- Punësimi 15 pikë
- Koha e vënies në punë 15 pikë

- Përvoja në këtë lloj veprimtarie  
ose në një veprimtari të ngjashme  
me të20 pikë

-Planbiznesi (për anën financiare)10 pikë.

5. Procedurat e shqyrtimit dhe të vlerësimit të ofertave të përfundojnë brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Fatos Nano**

## **V E N D I M**

**Nr.593, datë 28.8.2003**

### **PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION TË FORMËS "ROT" TË TEC-IT TË KOMBINATIT ENERGJETIK SHA NË ELBASAN**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## **V E N D O S I:**

1. Fillimin e procedurës për dhënie me koncesion të TEC-it të Kombinatit Energjetik sh.a., Elbasan me shoqërinë "Kurum International" sh.p.k., Tiranë, sipas propozimit të pakërkuar.

2. Koncesioni të jetë i formës "ROT" (rehabilitim-shfrytëzim-transferim).

3. Organi shtetëror i autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës koncesionare të jenë Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë.

4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Fatos Nano**

## **V E N D I M**

**Nr.594, datë 28.8.2003**

### **PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS "ROT" NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE TË ENERGJETIKËS DHE MINISTRISË SË EKONOMISË DHE SHOQËRISË "KURUM INTERNATIONAL" SHPK, TIRANË PËR FABRIKËN E OKSIGJENIT NË ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## V E N D O S I:

1. Miratimin e Marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT" ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës e Ministrisë së Ekonomisë dhe shoqërisë "Kurum International" sh.p.k., Tiranë për fabrikën e oksigjenit në Elbasan, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Fatos Nano**

### **MARRËVESHJE KONCESIONI FABRIKA E OKSIGJENIT ELBASAN**

Marrëveshje koncesioni e lidhur ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Ekonomisë Tiranë, që më poshtë do të quhet "Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA)", caktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.223, datë 10.4.2003, përfaqësuar nga z. Arben Ahmetaj me autorizimin nr.4093, datë 7.7.2003 të MIE-së dhe z. Ilir Ciko me autorizimin nr.5292, datë 3.7.2003 të ME-së dhe

"Kurum International" sh.p.k. Kombinati Metalurgjik Elbasan, me seli në Tiranë, regjistruar si person juridik me vendimin nr.20268, datë 10.11.1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet "Koncesionari", përfaqësuar nga z. Zeki Kaya, me autorizim të presidentit të "Kurum International", z. Hasmet Kurum.

Duke pasur parasysh që:

Në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit, Qeveria shqiptare i ka dhënë një rol prioritar zhvillimit dhe ristrukturimit të zonave industriale;

Legjislacioni në fuqi rregullon dhënien me koncesion të objekteve industriale;

Shoqëria "Kurum International" sh.p.k. është e interesuar të investojë në ish-Kombinatin Energjetik Elbasan, me qëllim realizimin e ristrukturimit gradual të fabrikës së oksigjenit për prodhimin e gazrave teknike për treg të brendshëm e të jashtëm;

Shoqëria "Kurum International" zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje;

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.223, datë 10.4.2003 "Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës "ROT", të fabrikës së oksigjenit Elbasan" autorizohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për negocimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së koncesionit.

Palët bien dakord të bashkëpunojnë për realizimin e projektit të rehabilitimit të fabrikës së oksigjenit Elbasan, sipas planbiznesit të paraqitur me koncesion të formës "ROT" (rehabilitim-shfrytëzim-transferim), sipas kushteve të mëposhtme:

#### Neni 1

#### **Përkufizime**

Kudo që në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet përkatëse të mëposhtme:

Marrëveshje koncesioni: Dokumenti në fjalë dhe anekset e tij.

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë.

Koncesionari: Shoqëria "Kurum International" sh.p.k., Elbasan.

Kontratat: Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari me sipërmarrësit për realizimin e punimeve.

Projekti: Studimi tekniko-ekonomik për rehabilitimin e fabrikës së oksigjenit Elbasan.

Anekset: Aneksi 1. Lista e objekteve që do të merren në koncesion. Aneksi 2. Plani i investimeve. Aneksi 3. Lista e punonjësve që dalin të papunë nga kjo Marrëveshje, të cilët janë pjesë integrale e Marrëveshjes së koncesionit.

## Neni 2

### **Objekti i koncesionit**

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është dhënia me koncesion e fabrikës së oksigjenit Elbasan, në formën "ROT" (rehabilitim-shfrytëzim-transferim).

- Rehabilitim, rristurim në parametrat, sipas planbiznesit të paraqitur, të tërësisë fizike dhe teknologjike të objektit.

- Operim optimal tekniko-ekonomik për prodhim oksigjeni dhe gazrave të tjera teknike.

- Transferim shtetit të tërësisë fizike dhe aseteve të ristrukturuara të objekteve në gjendje pune në përfundim të periudhës së koncesionit.

## Neni 3

### **Kriteret specifike të punimeve**

Plani i rehabilitimit do të realizohet për një periudhë maksimale prej 32 muajsh, që ndahet në 4 faza.

Faza e parë: Përpunimi i projektit të zbatimit të rikonstruksionit sipas provave të nyjeve teknologjike dhe konstruktive të sistemit të prodhimit. Kontrolli funksional (pa ngarkesë) i kullave 3200 NmK të sistemit të prodhimit.

Periudha 8 muaj. Vlera 250 000 USD.

Faza e dytë: Provat në ngarkesë dhe korrigjimi i parametrave teknologjikë. Fillimi i prodhimit të organizuar dhe i investimeve për pajisje dhe agregate ndihmëse. Stabilizimi teknologjik dhe prodhimi me kapacitet deri 85% të kapacitetit të projektit në kullën e dytë (njërën nga kullat 3200 pa prioritet). Riparimi i kullës dhe kontrolli i kompresorëve dhe këmbyesve të nxehtësisë. Periudha 8 muaj. Vlera 265 000 USD.

Faza e tretë: Investimi dhe aplikimi i pajisjeve të kontrollit elektronik në kullën tjetër. Kontrolli i kompresorëve të ajrit, të azotit të pajisjeve të transmetimit të nxehtësisë e të lubrifikimit.

Periudha 8 muaj. Vlera 660 000 USD.

Faza e katërt: Aplikimi i të gjitha investimeve, organizimi i prodhimit tërësor dhe arritja e parametrave teknologjikë dhe ekonomikë të projektit. Riparimi i pajisjeve ftohëse të gazit dhe të dy kompresorëve të tjerë të oksigjenit dhe azotit. Rikonstruksioni i nënstacionit elektrik. Testime të përgjithshme.

Periudha 8 muaj. Vlera 1 100 000 USD.

Totali i investimeve 2 275 000 USD.

Tabela e kostove është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje dhe i përket punimeve të parashikuara respektivisht të 4 fazave të përshkruara më lart.

## Neni 4

### **Fillimi i punimeve**

Koncesionari do të fillojë punimet brenda 10 ditësh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 5

### **Detyrimet e Koncesionarit**

- Koncesionari brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së koncesionit do të paraqesë pranë OSHA-së të gjitha ndryshimet e duhura të dokumentacionit në gjykatë, për të bërë të mundur

funksionimin e shoqërisë ekzistuese si shoqëri koncesionare sipas të drejtës shqiptare. Shoqëria do të jetë shoqëri tregtare dhe do t'u nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

- Koncesionari merr përsipër realizimin e objektit të Marrëveshjes së koncesionit, sipas planit të ristrukturimit të përcaktuar në nenin 3 dhe aneksit nr.2, bashkëlidhur.

- Koncesionari merr përsipër të paguajë shumën 110 000 USD për periudhën 18 muaj si pagë dhe si kontribut për sigurimet shoqërore për punonjësit që dalin të papunë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, sipas listës bashkëlidhur, pjesë integrale e Marrëveshjes.

Ky detyrim fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

Pagesa bëhet nga vetë Koncesionari, duke derdhur edhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Çdo muaj Koncesionari njofton OSHA-në për shlyerjen e pagesës.

- Koncesionari nuk përgjigjet për detyrimet që fabrika e oksigjenit ka me të tretët, para datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Koncesionari detyrohet:

- Të zbatojë punimet në përputhje me projektin e investimeve sipas parashikimeve të nenit 3.

- Të sigurojë drejtimin e punimeve dhe të realizojë provat e përshtatshme, duke mbajtur në informim të vazhdueshëm OSHA-në për avancimin e punimeve.

- Të administrojë objektin për periudhën e koncesionit dhe të respektojë të drejtën e OSHA-së për ruajtjen e pronësisë mbi objektet dhe mjetet kryesore të dhëna me koncesion.

- Detyrohet të paguajë të gjitha detyrimet tatimore që rrjedhin nga aktiviteti ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi.

- Të deklarojë dhe kontabilizojë të gjitha asetet që do të shtohen gjatë periudhës së koncesionit.

- Të zbatojë Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që lidhen me marrëdhëniet punëmarrës-punëdhënës.

- Të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga dëmtimet eventuale të personave apo të objekteve.

#### Neni 6

#### **Detyrimet e OSHA-së**

OSHA merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- T'i dorëzojë Koncesionarit objektin e koncesionit, sipas një procesverbali të hartuar nga palët, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

- Me kërkesën e Koncesionarit asiston për të marrë masat e nevojshme për organizimin e ruajtjes dhe sigurimit të zonës.

- Të asistojë në nxjerrjen e autorizimeve urbanistike, lejeve të ndërtimit, lejet e nevojshme të punimeve për realizimin e projektit.

- Të asistojë Koncesionarin pranë çdo organizmi shtetëror, në bazë rrethi e komune, enti e autoriteti shqiptar për realizimin e qëllimit të koncesionit sipas planbiznesit.

#### Neni 7

#### **Vlerësimi i investimeve**

Në bazë të planit të rehabilitimit (aneksi 2), vlera e investimeve do të jetë 2 275 000 USD.

Vlera e paraqitur më lart mund të pësojë ndryshime deri në 10% të vlerës totale pas përfundimit të projektit të zbatimit.

Nëse vlera totale e investimit bie nën kufirin minimal të tij, Koncesionari është i detyruar të rrisë nivelin e investimit për të arritur kufirin minimal të lejuar sipas nenit 7.

Koncesionari do t'i paraqesë OSHA-së faturat e blerjeve dhe shpenzimeve të tjera sipas planbiznesit, për të justifikuar vlerat e investuara.

Neni 8  
**Periudha e koncesionit**

OSHA i jep Koncesionarit, me koncesion fabrikën e oksigjenit të Kombinatit Energjetik në Elbasan, për një periudhë 30-vjeçare. Kjo periudhë do të fillojë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9  
**Programi i punimeve**

Koncesionari detyrohet të respektojë programin e parashikuar në planin e ristrukturimit dhe të punimeve përkatëse, siç është parashikuar në nenin 3 dhe aneksin nr.2.

Koncesionari garanton të zbatojë investimet e parashikuara në planin e rehabilitimit, me qëllim që të realizojë objektin e koncesionit. Projekti do të realizohet sipas specifikimeve në aneksin nr.2, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje dhe planbiznesit përkatës, të cilat janë pjesë integrale të saj.

Neni 10  
**Zgjidhja e Marrëveshjes së koncesionit**

OSHA mund të zgjidhë Marrëveshjen e koncesionit kur konstaton shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të marra nga Koncesionari, të tilla që kompromentojnë vazhdimësinë e punimeve të parashikuara në planin e ristrukturimit. Në rast se ngjarje të tilla verifikohen, OSHA duhet t'i komunikojë Koncesionarit shkeljet, duke pritur 30 ditë për një përgjigje shpjeguese.

Në qoftë se Koncesionari largohet në mënyrë të njëanshme para përfundimit të Marrëveshjes, investimet e kryera i mbeten shtetit shqiptar.

Neni 11  
**Kontratat**

Koncesionari ka të drejtë që të përdorë nënkontraktorë për realizimin e projektit.

Në të gjitha kontratat që do të lidhë Koncesionari me të tretët, ai duhet të respektojë ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe parashikimet në këtë Marrëveshje.

Koncesionari do të jetë përgjegjësi i vetëm kundrejt OSHA-së për zbatimin e përpiktë të projektit, pavarësisht nga kontratat që do të lidhen me të tretët.

OSHA nuk ka asnjë detyrim kundrejt të tretëve që lidhen me Koncesionarin dhe me këtë Marrëveshje.

Neni 12  
**Sigurimi, riparimi dhe mirëmbajtja**

Koncesionari do të bëjë sigurimin e objekteve të dhëna në koncesion, përsa i përket rrezikut kundër zjarrit, dëmtimeve e vjedhjeve. Riparimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave dhe strukturave të paluajtshme të zonës të ristrukturuar për periudhën e koncesionit.

Koncesionari pajis OSHA-në me kopjet e dokumentacionit përkatës për sigurimet e bëra.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose dëmtohet për shkak të rreziqeve për të cilat është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga Koncesionari për këtë qëllim do të përdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen funksionuese në parametrat e projektit.

Neni 13  
**Kontrolli dhe inspektimi**

OSHA ka të drejtën e inspektimit të objektit të koncesionit, punimeve, për të kontrolluar kryerjen e punimeve dhe të investimeve në përputhje me projektin e paraqitur. Koncesionari do të japë çdo sqarim teknik të kërkuar. Në çdo rast, kur OSHA konstaton parregullsi, do t'ia komunikojë me

shkrim vërejtjet, duke i bërë thirrje Koncesionarit të vazhdojë punimet sipas aneksit.

#### Neni 14

##### **Legjislacionit që do t'i referohet**

OSHA garanton se gjithçka që është vendosur në kontratën në fjalë nuk mund të ndryshohet nga norma ligjore në të ardhmen.

Ligji i aplikueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar.

#### Neni 15

##### **Forca madhore**

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, gjendja e luftës, që kanë fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj Marrëveshjeje, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e Palëve.

Gjatë zbatimit të Marrëveshjes, në rast se verifikohen ngjarje të forcës madhore, vonesa të mundshme ose mosrespektim të detyrimeve të Palëve, ato nuk mund të jenë motiv për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj Marrëveshjeje do të prishet ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim Palën tjetër, duke i treguar dhe duke arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat. OSHA ka të drejtën t'i verifikojë ato.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve do të konfirmohen nga Palët në një procesverbal të ngjarjes rast pas rasti.

#### Neni 16

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve nuk do të ndërpresë ekzekutimin e detyrimeve. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, atëherë zgjidhen nga arbitri i pajtimit, i emëruar me vullnet të të dyja Palëve dhe nga dy ekspertë të emëruar një nga OSHA dhe një nga Koncesionari. Në rast mospajtimi të mëtijshëm, Marrëveshja do të zgjidhet duke iu drejtuar Gjykatës së Rrethit Tiranë.

#### Neni 17

##### **Sanksionet**

Në rast të shkeljeve të afateve të programit të rehabilitimit për faj të Koncesionarit, të përcaktuara në nenin 3, Koncesionari do t'i paguajë OSHA-së për çdo ditëvonesë penaltetin 0.01% të vlerës së investimit të përealizuar për çdo fazë.

#### Neni 18

##### **Bashkëpunimi**

OSHA dhe Koncesionari detyrohen reciprokisht për të bashkëpunuar dhe kooperuar ndërmjet tyre, me qëllim që të garantohet një efikasitet maksimal.

#### Neni 19

##### **Dispozita të përgjithshme**

OSHA dhe Koncesionari do t'i komunikojnë njëri-tjetrit emrin e të ngarkuarit për të firmosur aktin në fjalë, që do të hartohet në shqip, si dhe anekset bashkëlidhur në katër kopje origjinale, dy për OSHA-në, një për Koncesionarin dhe një për noterin.

Neni 20  
**Hyrja në fuqi e Marrëveshjes**

Marrëveshja në fjalë, si dhe anekset bashkëlidhur, që janë pjesë integrale e saj, do të hyjnë në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe mbasi të jetë miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995.

PËR OSHA-në  
Arben Ahmetaj  
Ilir Ciko

PËR SHOQËRINË  
"KURUM INTERNATIONAL" SHPK  
Zeki Kaya

**ANEKSI I**

PLANIMETRIA E FABRIKËS SË OKSIGJENIT ELBASAN  
SIPËRFAQET KRYESORE:  
SIPËRFAQJA E PËRGJITHSHME 27 875 508 m<sup>2</sup>  
SIPËRFAQE TË LIRA 16058 46 m<sup>2</sup>  
RRUGË E SHESHE TË ASFALTUARA 3427 50 m<sup>2</sup>  
SIPËRFAQJA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE 8389 548 m<sup>2</sup>  
Dimensionet e kufirit teknologjik të fabrikës të jepen në genplan.

**KUFIZIMET:**

Nga veriu Rrugë dhe tokë e papunuar  
Nga jugu Tokë e papunuar  
Nga lindja Përroi i Kushes  
Nga perëndimi Objekte të TEC-it

**FABRIKA E OKSIGJENIT SHA (OBJEKTET):**

1. Freskorja
2. Stacioni i pompave
3. Depo e perlitit
4. Magazina rikupero
5. Mensa
6. Depo e vajit
7. Godina e administratës
8. Ambiente të shërbimit mekanik
9. Reparti i bombolave të gazit me 346 588 m<sup>2</sup>
10. Dushe dhe garderoba
11. Tri sfera të depozitimit të oksigjenit
12. Stacioni i reduktimit
13. Dy kullat me kapacitet 3200 Nmk
14. Salla e kompresorëve
15. Nënstacioni
16. Ambiente pune
17. Linja e tubacioneve teknologjike
18. Linjat e tensionit që lidhen me sistemin e energjisë kombëtare

Shënim: Bashkëngjitur paraqesin genplanin e fabrikës për koncesion

- Kullat 6800 Nmk i jepen me ruajtje firmës "Kurum International" për një periudhë 3-vjeçare.  
Në fund të kësaj periudhe firma Kurum duhet të paraqesë planbiznesin për ristrukturimin e tyre, në të

kundërt do t'i kthehen OSHA-së.

## ANEKSI 2

### PROGRAMI I INVESTIMEVE DHE I PRODHIMIT

|                                                                                                |              |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| Periudha e parë: 6 deri 8 muaj                                                                 |              |
| - Kontrolli i plotë pa ngarkesë i sistemit prodhues                                            | 5 000 \$     |
| - Riparimi pa ndryshime tekniko-teknologjike i kullës me kapacitet 3200 Nmk (normal metër kub) | 240 000 \$   |
| - Kontrolli dhe shërbimi i rrjetit teknologjik                                                 | 5 000 \$     |
| Gjithsej                                                                                       | 250 000 \$   |
| Periudha e dytë: 6 deri 8 muaj                                                                 |              |
| - Riparimi metodik i kullës së dytë 3200 Nmk                                                   | 80 000 \$    |
| - Kontrolli dhe riparimi i rrjetit të tubacioneve                                              | 5 000 \$     |
| - Kontrolli dhe riparimi i kompresorëve dhe i këmbyesve të nxehtësisë                          | 180 000 \$   |
| Gjithsej                                                                                       | 265 000 \$   |
| Periudha e tretë: 6 deri 8 muaj                                                                |              |
| - Kontrolli dhe riparimi i kompresorit të ajrit                                                | 450 000 \$   |
| - Kontrolli dhe riparimi i kompresorit të azotit                                               | 60 000 \$    |
| - Riparimi i sistemeve të transmisionit                                                        | 10 000 \$    |
| - Riparimi i këmbyesve të nxehtësisë                                                           | 120 000 \$   |
| - Kontrolli dhe riparimi i sistemit të lubrifikimit                                            | 20 000 \$    |
| Gjithsej                                                                                       | 660 000 \$   |
| Periudha e katërt: 6 deri 8 muaj                                                               |              |
| - Riparimi i pajisjeve të ftohjes së gazit                                                     | 300 000 \$   |
| - Riparimi i dy kompresorëve të tjerë të azotit                                                | 80 000 \$    |
| - Riparimi i tre kompresorëve të tjerë të oksigjenit                                           | 420 000 \$   |
| - Rikonstrukcioni i nënstacionit elektrik                                                      | 120 000 \$   |
| - Organizimi sipas konceptit të strukturës së re                                               | 100 000 \$   |
| - Testimi i sistemit në tërësi pas rikonstrukcionit                                            | 80 000 \$    |
| Gjithsej                                                                                       | 1 100 000 \$ |
| Shuma totale e investimeve                                                                     | 2 275 000 \$ |

Ky projekt do të fillojë të zbatohet pas nënshkrimit të kontratës. Por mbështetur në marrëveshjen e mirëkuptimit, Kompania Internacional sh.p.k. ka filluar të plotësojë disa detyra të periudhës së parë të zbatimit të projektit e konsideruar si faza përgatitore dhe përshpejtuese.

Mbi bazë të nevojave kombëtare për oksigjen, sipas rritjes së prodhimit të çelikut në Shqipëri dhe mundësive për eksport në rajonin tonë, Kompania jonë e shikon të mundshme dhe ka marrë të gjitha masat studimore për të aktivizuar në procesin e prodhimit të dy kullave me kapacitet 6800 Nmk, të cilat prej shumë kohësh janë jashtë përdorimit. Po kështu mendohet të ndërtohet një linjë e re për prodhimin e gazit argon, i cili duke qenë një produkt i ri në nomenklaturën e prodhimeve shqiptare është edhe prodhim me vlera të dukshme në ekonomi.

Këto dy zhvillime do të kërkojnë, pa dyshim, investime të tjera në vlera deri në 2 500 000\$. Ky objektivi do të mund të shtrohet për zgjidhje pas tre viteve të para të prodhimit.

Prodhimi i garantuar: 260 Nmk/orë (ose 80% e vlerës së projektit) për kullat me kapacitet 3200 Nmk.

## ANEKSI 3

### LISTA E PUNONJËSVE TË KOMBINATIT ENERGJETIK SHA SIPAS MARRËVESHJES

## KONCESIONARE

|                       |                               |
|-----------------------|-------------------------------|
| 1. Natasha Haxhillari | Inxhiniere teknologe          |
| 2. Lumturi Mushu      | Inxhiniere mekanike           |
| 3. Fatmir Qosja       | Inxhinier elektrik            |
| 4. Lefteri Dedja      | Ekonomiste                    |
| 5. Dafina Subashi     | Sekretare, pastruese          |
| 6. Arben Sula         | Punëtor                       |
| 7. Todi Belshi        | K/teknolog                    |
| 8. Dalip Hasko        | Teknolog i parë               |
| 9. Fatri Lufta        | Teknolog i parë               |
| 10. Ardjan Kulejmani  | Teknolog i parë               |
| 11. Luftar Subashi    | Teknolog i dytë               |
| 12. Xhavadir Hoxha    | Teknolog i dytë               |
| 13. Halim Halili      | Teknolog i dytë               |
| 14. Albert Bejleri    | Teknolog i dytë               |
| 15. Agim Boçi         | Kompresorist ajri             |
| 16. Mustafa Zeka      | Kompresorist ajri             |
| 17. Skënder Stafa     | Kompresorist ajri             |
| 18. Njazi Sejдини     | Kompresorist ajri             |
| 19. Spiro Nako        | Kompresoriste oksigjeni       |
| 20. Sofie Nako        | Kompresoriste oksigjeni       |
| 21. Jeta Shuli        | Kompresoriste oksigjeni       |
| 22. Bexhete Sala      | Kompresoriste oksigjeni       |
| 23. Leonard Gurre     | Pompist, kompresorist azoti   |
| 24. Liljana Eski      | Pompiste, kompresorist azoti  |
| 25. Loreta Toçi       | Pompiste, kompresorist azoti  |
| 26. Gure Balla        | Pompiste, kompresoriste azoti |
| 27. Nazmie Muça       | Elektriçiste nënstacioni      |
| 28. Demir Samarxhiu   | Elektriçist nënstacioni       |
| 29. Fanie Bodurri     | Elektriçist nënstacioni       |
| 30. Argjiro Murataj   | Elektriçist nënstacioni       |
| 31. Filloreta Marku   | Laborante                     |
| 32. Sotir Shukle      | Mekanik                       |
| 33. Isa Dika          | Mekanik                       |
| 34. Ilirjan Moli      | Mekanik                       |
| 35. Veniamin Peligriu | Mekanik                       |
| 36. Nikolla Risto     | Kipist                        |
| 37. Avni Peposhi      | Saldator                      |
| 38. Beqir polisi      | Shofer                        |
| 39. Fatos Shqerra     | Mekanik                       |
| 40. Dhimitraq Kote    | Kompresorist                  |
| 41. Piro Jani         | Kompresorist                  |
| 42. Ymer Karina       | Kompresorist                  |
| 43. Natasha Gusmari   | Ekonomiste                    |
| 44. Bukurie Haxhiu    | Teknologe                     |
| 45. Albina Trebicka   | Teknologe                     |
| 46. Zyra Doçi         | Teknologe                     |
| 47. Vjollca Nako      | Kompresoriste                 |
| 48. Jalldyz Dardha    | Kompresoriste                 |
| 49. Naxhiferr Zharri  | Teknologe                     |
| 50. Suzana Bodurri    | Teknologe                     |
| 51. Mimoza Gorea      | Elektriçiste                  |
| 52. Adile Isaku       | Elektriçiste                  |
| 53. Lutfie Dauti      | Elektriçiste                  |

|                       |              |
|-----------------------|--------------|
| 54.Vehbi Bekteshi     | Kipist       |
| 55.ëngjëllushe Hatibi | Kipiste      |
| 56.Merita Periu       | Kipiste      |
| 57.Fatmira Ndreka     | Kipiste      |
| 58.Dafina Zhelegu     | Kipiste      |
| 59.Manushaqe Gurra    | Pompiste     |
| 60.Fatbardha Boçi     | Elektriçiste |
| 61.Sadie Asllani      | Elektriçiste |
| 62.Ikbal Sina         | Elektriçiste |
| 63.Bashkim Bala       | Mekanik      |
| 64.Mark Vata          | Mekanik      |
| 65.Ymer Bakalli       | Mekanik      |
| 66.Kasem Dyrmishi     | Tornitor     |
| 67.Majlinda Frashëri  | Magaziniere  |
| 68.Sabrije Deliu      | Mekanike     |
| 69.Luljeta Selita     | Mekanike     |
| 70.Naim Toçku         | Saldator     |
| 71.Fejzi Terko        | Shofer       |
| 72.Dhimitra Nikolla   | Punëtore     |
| 73.Zhani Beçka        | Punëtore     |
| 74.Athina Karamelo    | Punëtore     |
| 75.Donika Bendo       | Punëtore     |
| 76.Suzana Hoxholli    | Punëtore     |
| 77.Anita Çaushti      | Punëtore     |
| 78.Andrea Veshi       | Punëtor      |
| 79.Qamil Lloçja       | Punëtor      |
| 80.Refik Kamara       | Punëtor      |
| 81.Bajram Cani        | Punëtor      |
| 82.Saide Dedja        | Punëtore     |
| 83.Isak Bishqemi      | Punëtor      |
| 84.Skënder Ibrahim    | Punëtor      |
| Gjithsej              | 84           |

**V E N D I M**  
**Nr.596, datë 28.8.2003**

**PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË AKADEMINË E  
POLICISË "ARBEN ZYLYFTARI" PËR VITIN AKADEMIK 2003-2004**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Kuota e pranimit të studentëve në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari", për vitin akademik 2003-2004, të jetë 50 (pesëdhjetë) studentë.
  2. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**U D H Ë Z I M**  
**Nr.6, datë 14.3.2003**

**PËR REGJISTRIMIN E INSTITUCIONEVE TË AFP-SË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

**U D H Ë Z O J M Ë:**

1. Institucionet, të cilat ofrojnë arsim dhe formim profesional, i nënshtrohen procesit të regjistrimit dhe përkatësisht për arsimin profesional në drejtoritë arsimore të rrethit përkatës dhe për formim profesional në zyrat e punësimit të rrethit përkatës. Procesi i licencimit bëhet përkatësisht në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

2. Këto institucione duhet të paraqesin në drejtoritë arsimore të rrethit përkatës (ku do të ushtrojnë aktivitetin) apo në zyrat e punësimit të rrethit përkatës (ku do të ushtrojnë aktivitetin) dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë
- Përshkrim i aktivitetit të arsim/formimit profesional

3. Drejtoritë arsimore të rretheve përkatëse dhe zyrat e punësimit të rretheve përkatëse mbajnë regjistrat e regjistrimit dhe lëshojnë vërtetim për regjistrimin sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Drejtoritë arsimore dhe zyrat e punësimit dërgojnë në ministrinë përkatëse informacion mujor mbi numrin e institucioneve të regjistruara.

5. Inspektorati Shtetëtor i Punës dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ushtrojnë kontroll për procesin e regjistrimit dhe licencimit.

6. Procesi i regjistrimit nuk presupozon miratimin e programeve mësimore dhe atyre të formimit profesional.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE I SHKENCËS

**Luan Memushi**

MINISTRE E PUNËS DHE E ÇËSHTJEVE  
SOCIALE

**Valentina Leskaj**

**U D H Ë Z I M**  
**Nr.17, datë 1.9.2003**

**PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONET E KOMISIONIT TË  
AKREDITIMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të vendimit nr.543, datë 31.10.2002 të Këshillit të Ministrave "Për akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional (AFP)"

**U D H Ë Z O J M Ë:**

1. Komisioni i akreditimit të arsimit dhe formimit profesional ka në përbërje të tij:

- dy përfaqësues nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale;
- dy përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

2. Komisioni kryesohet me rotacion një vit nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe një vit nga përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Përfaqësuesit e secilës ministri, si dhe ai në rolin e kryesuesit përcaktohen nga ministrat përkatës, nga nëpunës civilë që mbulojnë përkatësisht fushën e formimit dhe të arsimit profesional.

3. Komisioni thirret nga kryesuesi me njoftim me shkrim, në të cilin përcaktohet data, ora, vendi i mbledhjes dhe rendi i ditës. Komisioni mbledhet të paktën një herë në muaj dhe në rast nevojë e urgjence menjëherë.

4. Komisioni i akreditimit merr vendim, pasi shqyrton materialin e paraqitur nga institucioni kërkuar për t'u akredituar dhe pasi dëgjon relacionin vlerësues të ekspertëve për institucionin. Në përfundim të shqyrtimit Komisioni i akreditimit shprehet për:

- dhënien e akreditimit;
- mosakreditimin;
- plotësim të metash;
- shtyrje për shqyrtim të mëvonshëm.

Në çdo rast vendimi i Komisionit të jetë i arsyetuar dhe i bazuar ligjërisht. Komisioni merr vendim me shumicën e votave, kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve. Në rast barazie votash, përcaktuese është vota e kryetarit të Komisionit.

5. Komisioni i akreditimit ndihmohet nga një sekretari teknike, që përbëhet nga dy specialistë, njëri që mbulon formimin profesional dhe tjetri që mbulon arsimin profesional në ministratë përkatëse.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi secili ministër përcakton përfaqësuesit e ministrisë. Vitin e parë të funksionimit Kryetari i komisionit caktohet me short nga dy përfaqësuesit, që janë përcaktuar për një funksion të tillë nga ministrat përkatës.

7. Mbledhja e parë e Komisionit mbahet brenda 10 ditëve nga caktimi i përfaqësuesve të ministrive.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE I SHKENCËS

**Luan Memushi**

MINISTRE E PUNËS DHE E ÇËSHTJEVE  
SOCIALE

**Valentina Leskaj**

## **U D H Ë Z I M** **Nr.437, datë 3.3.2003**

### **PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË FORMIMIT PROFESIONAL**

1. Ky udhëzim del në zbatim të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" neni 23 pika b.

2. Licencimi bëhet për ato subjekte që ofrojnë deri në 3 kurse të formimit profesional. Licencimi i tyre bëhet në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit që duhet të plotësohet nga subjekti që do të kryejë aktivitetin.

3. Dokumentet që duhet të plotësohen janë:

a) Për subjekte shtetërore:

i) Vërtetimi i regjistrimit si ofrues i formimit profesional në zyrën e punësimit.

ii) Programi i kurseve që do të hapë.

iii) Curriculumet e stafit kualifikues.

iv) Deklarata për dhënie informacioni në lidhje me ecurinë e formimit në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale në mbarim të çdo kursi.

v) Deklarata për dhënien e informacionit SHKP në lidhje me procesin e formimit.

vi) Leja higjieno-sanitare e noterizuar.

- vii) Marrëveshja me sigurimet shoqërore për stafin kualifikues e noterizuar.
- viii) Diplomat dhe certifikatat të stafit kualifikues të noterizuara.
- ix) Fatura e pagesës për marrjen e autorizimit.
- b) Organizata jofitimprurëse dhe subjekte private:
  - i) Vërtetimi i regjistrimit si ofrues i formimit profesional në zyrën e punësimit.
  - ii) Dokument ose deklaratë ku të vërtetohet burimi i financimit (vetëm për organizatat jofitimprurëse.
  - iii) Vërtetim i regjistrimit në zyrën e tatimeve (vetëm për subjektet private).
  - iv) Një kopje e statutit e noterizuar.
  - v) Programi i kurseve që do të hapë.
  - vi) Curriculumet e stafit kualifikues.
  - vii) Deklarata për dhënie informacioni në lidhje me ecurinë e formimit në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale në mbarim të çdo kursi.
  - viii) Dokumente që vërtetojnë pronësinë ose marrjen me qira të ambienteve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit, si dhe të pajisjeve didaktike të nevojshme.
  - ix) Deklarata për dhënien e informacionit SHKP në lidhje me procesin e formimit.
  - x) Leja higjieno-sanitare.
  - xi) Marrëveshja me sigurimet shoqërore për stafin kualifikues.
  - xii) Diploma dhe certifikata të stafit kualifikues.
  - xiii) Fatura e pagesës për marrjen e autorizimit.
- 4. Dokumentet dorëzohen në dy kopje (njëra e noterizuar dhe tjetra fotokopje) dhe depozitohen në Drejtorinë e Formimit Profesional në SHKP, e cila i shqyrton, përgatit relacionin argumentues për licencimin e subjekteve dhe ia paraqet ato Drejtorisë së Politikave të Punësimit në MPÇS.
  - Drejtoria e Formimit Profesional në SHKP merr masa për të kontrolluar paraprakisht subjektin që aplikon për t'u licencuar.
  - Drejtoria e Politikave të Punësimit përgatit licencën e subjektit përkatës dhe ia paraqet për firmë Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.
  - 5. Dhënia e përgjigjes për marrjen ose jo të licencës nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale bëhet brenda një muaji nga data e depozitimit të dokumentacionit të plotë në SHKP.
  - 6. Licenca është e vlefshme për një periudhë kohore një vit nga data e dhënies së saj. Në rastet kur kurset e organizuara nga subjektet e mësipërme janë dyvjeçare licenca është e vlefshme për 2 vjet. Në këto raste subjekti duhet të derdhë një tarifë 50% më të lartë, sesa tarifat e parashikuara në pikën 12 dhe 13 të këtij udhëzimi.
  - 7. Ripërtëritja e licencës bëhet brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të afatit. Për ripërtëritjen e licencës paraqiten këto dokumente:
    - a) Për subjektet shtetërore të paraqiten dokumentet (i), (ii), (iv), (v), (vi), (vii), (viii), (ix) të pikës 3.a.
    - b) Për organizatat joqeveritare dhe subjektet private të paraqiten dokumentet (i), (ii) (për organizatat joqeveritare), (iii), (për subjektet private), (v), (vii), (ix), (xi), (xiii) të pikës 3.b.
    - c) Kur subjektet e mësipërme punësojnë staf të ri kualifikues të paraqiten diplomat dhe certifikatat e tyre.
  - 8. Subjekti i licencuar është i detyruar të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Formimit Profesional në SHKP, për datat e zhvillimit të testeve përfundimtare të paktën dy javë përpara.
  - 9. Certifikatat firmosen dhe vulosen nga subjekti i licencuar dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Formimit Profesional të SHKP-së apo personat përgjegjës të autorizuar prej tij.
  - 10. Çdo subjekt që organizon aktivitete formimi duhet të mbajë një regjister për mbarëvajtjen e çdo kursi, ku të shënohen prezenca dhe përparimi i kursantëve. Krahas regjistrimit për mbarëvajtjen e kursit, të shtohet edhe regjistri i regjistrimit të kursantëve me numër amze.
  - 11. Në fillim të çdo kursi subjekti i licencuar është i detyruar të dërgojë një listë të kursantëve pjesëmarrës në kurse në Drejtorinë e Formimit Profesional të SHKP-së.
  - 12. Tarifa për pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit është 3000 lekë dhe derdhet në financën e SHKP-së. Në rastet e ripërtëritjes së licencës, pranimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit bëhet falas.
  - 13. Tarifat për lëshimin e licencimit derdhen në financën e Ministrisë së Punës dhe të

Çështjeve Sociale dhe janë si më poshtë:

a) Subjekti shtetëror

Tarifa kur kryhen për herë të parë aktivitete të tilla të jetë 2000 lekë.

Tarifa për ripërtëritje kur është në vazhdimësi 1000 lekë.

b) Organizata joqeveritare dhe subjekte private vendase

Tarifa kur kryhen për herë të parë aktivitete të tilla të jetë 5000 lekë.

Tarifa për ripërtëritje kur është në vazhdimësi 2000 lekë.

c) Për OJF dhe subjekte të huaja

Tarifa për aktivitete të tilla të jetë 100 USD.

Tarifa për ripërtëritje kur është në vazhdimësi është 100 USD.

14. Drejtoria e Formimit Profesional e SHKP paraqet një informacion çdo 3 muaj në Drejtorinë e Politikave të Punësimit në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale në lidhje me ecurinë e formimit profesional në qendrat e licencuara sipas këtij udhëzimi.

15. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr një rregullore të brendshme në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi.

16. Kontrolli i këtyre qendrave bëhet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në zbatim të nenit 24 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

17. Drejtoria e Politikave të Punësimit pajis çdo subjekt që licencohet me udhëzimin "Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional".

18. Udhëzimi nr.2139, datë 10.12.2001 i Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354, datë 13.5.1996, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRE E PUNËS DHE E ÇËSHTJEVE SOCIALE

**Valentina Leskaj**

## **U D H Ë Z I M**

### **PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.465, DATË 3.7.2003 "PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPAUNË NGA PROCESI I MODERNIZIMIT TË AGJENCISË NACIONALE TË TRAFIKUT AJROR SHA"**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003 "Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i modernizimit të Agjencisë Nationale të Trafikut Ajror sh.a., Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit

## **U D H Ë Z O J N Ë:**

1. Në zbatim të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003, punonjësit që dalin të papunë, si pasojë e procesit të modernizimit të Agjencisë Nationale të Trafikut Ajror sh.a., Tiranë, trajtohen financiarisht për një periudhë 2-vjeçare në masën 100% të pagës bazë mujore, të shtesës së vjetërsisë në punë dhe për sigurimet e detyrueshme, në çastin e shkëputjes nga puna.

2. Pagesa e punonjësve sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003, bëhet nga zyra e punësimit të vendbanimit të punonjësve, vetëm pas paraqitjes së listave të punonjësve nga drejtoria përkatëse.

3. Periudha 2-vjeçare konsiderohet vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Në zbatim të kësaj pike personat përfitues kanë të drejtën e trajtimit me pagesë papunësie, pas përfundimit të trajtimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003.

4. Të drejtën e trajtimit sipas kritereve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003 e kanë të gjithë ata punonjës të cilët vërtetojnë se nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formë punësimi ose vetëpunësimi. Çdo person është i detyruar të paraqesë vërtetim nga dega e tatim-taksave të rrethit ku ka vendbanimin. Personat që vetëpunësohen ose punësohen gjatë periudhës së trajtimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003, duhet të bëjnë deklaratë në zyrën e punësimit për të ndërprerë pagesën, në të kundërt detyrohen të zhdëmtojnë shumën e përfituar

padrejtësisht.

5. Për të përfituar të drejtën e trajtimit sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003, punonjësit që dalin të papunë duhet të paraqesin në zyrën përkatëse të punësimit këto dokumente:

- Librezën e punës ku të shkruhet shkaku i ndërprerjes: "Dalje i papunë nga procesi i modernizimit të shoqërisë ANTA sh.a., Tiranë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003". Libreza e punës të jetë e vulosur nga titullari i shoqërisë.

- Vërtetim nga organet tatimore të rrethit ku të shënohet nëse punonjësi kryen ose jo aktivitet privat.

- Certifikatën e gjendjes familjare.

6. Pagesat për punonjësit realizohen me listëpagesa të veçanta në datat e përcaktuara nga zyrat e punësimit.

7. Në rast mosparaqitjeje të përfituesit në datën e caktuar, paga e tij arkëtohet jo më vonë se brenda 5 ditëve, duke filluar nga data e kryerjes në fakt të pagesave.

8. Fondet financiare të nevojshme për kryerjen e këtyre pagesave, sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003, do të transferohen nga ANTA sh.a. në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo 2 muaj. Transferimi i fondeve të bëhet 2 javë para datës së vendosur për kryerjen e pagesave nga zyra e punësimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**Valentina Leskaj**  
MINISTRE E PUNËS DHE E ÇËSHTJEVE  
SOCIALE

**Arben Malaj**  
MINISTËR I EKONOMISË

**Spartak Poçi**  
MINISTËR I TRANSPORTIT DHE I TELEKOMUNIKACIONIT

## **U D H Ë Z I M** **Nr.6 datë 5.9.2003**

### **PËR MËNYRËN E NGRITJES DHE ÇAKTIMIN E VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT**

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 31 pika 1b, nenit 43 pika 3 dhe neneve 62, 94, 95, 96 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

#### **U D H Ë Z O N:**

##### **Neni 1**

a) KZQV-ja është autoriteti i cili përcakton vendndodhjen e çdo qendre votimi dhe i cakton secilës prej tyre një numër.

b) Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, KZQV-ja bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe këtij udhëzimi.

c) Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 12.10.2003, qendrat e votimit do të përdorin si numër atë të përcaktuar nga KQZ-ja, sipas Sistemit Unik të Numërimit.

##### **Neni 2**

Në rastet kur ngrihet një qendër e re votimi, atëherë kësaj do t'i caktohet një kod pesëshifror sipas rregullit të mëposhtëm:

Nëse qendra e re e votimit krijohet për shkak të tejkalimit të numrit të zgjedhësve në një qendër votimi aktuale, atëherë numërimi i kësaj qendre të re do të realizohet duke i vendosur një kod pesëshifror. Katër shifrat e para të këtij kodi do të jenë të njëjta me katër shifrat e kodit të qendrës së

votimit ekzistuese, e cila ndahet, ndërsa shifra e pestë do të jetë 1 (një). Në rastet kur këtij kodi me shifër të fundit 1 (një), i është caktuar një qendër tjetër votimi, atëherë si shifër e pestë do të caktohet numri më i parë i pacaktuar. Në rastet kur kemi ngritje të një qendre të re votimi, atëherë katër shifrat e para të këtij kodi do të jenë ato të qendrës së votimit nga e cila ndahet ekzistuese më të afërt, ndërsa shifra e pestë do të jetë 1 (një). Në rastet kur, këtij kodi me shifër përfundimtare 1 (një) i është caktuar një qendër tjetër votimi, atëherë si shifër e pestë do të caktohet numri më i parë i pacaktuar.

### Neni 3

Në rastet kur KZQV-ja vendos të mbyllë një qendër votimi, atëherë kodi i kësaj qendre votimi hiqet nga përdorimi, duke mos ndryshuar kodet e tjera të qendrave të votimit.

### Neni 4

Për ngritjen dhe organizimin e qendrave të votimit, KZQV-ja duhet të mbajë parasysh:

- a) Zona e qendrës së votimit nuk mund të ndahet në pjesë të shkëputura nga njëra-tjetra.
- b) Zona e qendrës së votimit për aq sa është e mundur duhet të ketë jo më shumë se 1000 zgjedhës.
- c) Nëse zona e qendrës së votimit ka më shumë se 1000 zgjedhës, KZQV-ja kur e çmon mund të ngrejë një qendër votimi tjetër.
- d) Kur një qendër e shkëputur banimi, që ka jo më pak se 50 zgjedhës është larg nga qendra më e afërt e votimit më shumë se 3 km, aty krijohet një qendër votimi.
- e) Për asnjë arsye nuk lejohet ngritja e një qendre votimi me më pak se 50 zgjedhës.

### Neni 5

KZQV-ja, për çdo lloj arsye nuk mund të ngrejë një ose më shumë qendra votimi apo të mbyllë një ose më shumë qendra votimi më vonë se 21 ditë nga dita e votimit. Vendimi i KZQV-së për ngritjen apo mbylljen e qendrave të votimit bëhet publik dhe i dërgohet menjëherë KQZ-së.

### Neni 6

- a) Në rastet kur KZQV-ja vendos për mbylljen e një qendre votimi, zgjedhësit e kësaj qendre votimi përfshihen në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit më të afërt gjeografikisht.
- b) Në rastet kur KZQV-ja vendos krijimin e një qendre votimi, zgjedhësit e kësaj qendre votimi ndahen në dy lista zgjedhësish me numër përafërsisht të barabartë duke respektuar rendin alfabetik të mbiemrit të zgjedhësve.
- c) Vendndodhja e qendrës së votimit të krijuar duhet të jetë sa më afër qendrës së votimit nga e cila u nda.

### Neni 7

- a) KZQV-ja mund të ngrejë një qendër votimi në institucionet e posaçme ku ka jo më pak se 15 zgjedhës.
- b) Drejtuesi i institucionit të posaçëm, jo më vonë se dy ditë nga data e zgjedhjeve i dërgon KZQV-së listën e personave të cilët qëndrojnë në institucion. KZQV-ja verifikon se cilët persona janë në listën e zgjedhësve të njësisë zgjedhore ku ndodhet institucioni i posaçëm dhe harton listën e zgjedhësve që do të votojnë në qendrën e votimit të posaçme.
- c) Verifikimi i zgjedhësve, që ndodhen në listën e zgjedhësve të Bashkisë së Tiranës bëhet nga KZQV-ja e njësisë bashkiake që mbulon institucionin e posaçëm në bashkëpunim me KZQV-në e Bashkisë Tiranë.

### Neni 8

Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit do të procedohet si vijon:

a) Qendrat e votimit caktohen në objekte publike, si shkolla, konvikte, kopshte, çerdhe, ambulanca, qendra shëndetësore apo kulturore ose objekte të tjera të kësaj kategorie. Në këto objekte mund të ngrihet një ose më shumë qendra votimi. Qendra e votimit duhet të ngrihet për aq sa është e mundur në qendër të zonës së qendrës së votimit.

b) Vetëm në rastet kur në territorin e zonës së qendrës së votimit nuk ka asnjë objekt publik si ato të përmendura më lart, KZQV-ja vendos t'i propozojë KQZ-së krijimin e qendrës së votimit në ambiente, pronë private duke respektuar këtë radhë:

(i) Objekte social-kulturore sikundër përmenden në nenin 10 pika a, bare, restorante dhe shtëpi banimi, duke fiksuar në vendimin propozues për KQZ-në, emrin e objektit dhe emrin dhe mbiemrin e pronarit.

c) KZQV-ja duhet që si rregull të caktojë vendndodhjen e qendrës së votimit në të njëjtin vend me atë të zgjedhjeve të mëparshme.

d) Ambienti ku do të vendoset qendra e votimit duhet të plotësojë këto kritere:

i) të jetë i tillë që të lejojë qarkullimin e lirë të zgjedhësve dhe vëzhguesve;

ii) të ketë sipërfaqe jo më të vogël se 20m<sup>2</sup>;

iii) të jetë e pajisur me tavolina pune për anëtarët e KQV-së, për vendosjen e kutisë së votimit dhe për vendosjen e dhomës së fshehtë;

iv) të ketë ndriçim me energji elektrike;

v) brenda mundësive ambienti i qendrës së votimit duhet të jetë i tillë që të lehtësojë pjesëmarrjen në votim të personave me aftësi të kufizuara;

vi) ambienti i qendrës së votimit duhet të jetë i tillë që të lejojë afishimin në vend të dukshëm të listës së zgjedhësve, akteve të KZQV-së, si dhe materialeve informuese.

#### Neni 9

a) Mbi bazën e procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim, KZQV-ja jo më vonë se 21 ditë nga data e zgjedhjeve, merr vendim për vendndodhjen e qendrave të votimit, si dhe shpall vendndodhjen e qendrave të votimit sipas modeleve të dokumenteve të miratuara nga KQZ-ja.

b) KQZ-ja merr vendim për caktimin e qendrave të votimit në ambiente private jo më vonë se 2 javë nga data e zgjedhjeve.

#### Neni 10

Ambientet e caktuara për qendra votimi u vihen në dispozicion komisioneve të qendrave të votimit 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

### **U D H Ë Z I M** **Nr.7, datë 13.9.2003**

#### **PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE, KRYETARIT, ZV/KRYETARIT DHE SEKRETARIT TË KQV-SË**

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 43 pika 3 dhe e nenit 45 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

#### **U D H Ë Z O N:**

#### Neni 1

a) KZQV-ja është autoriteti i cili bën emërimin e anëtarëve, kryetarit, zv/kryetarit dhe sekretarit për çdo KQV të bashkisë/komunës përkatëse.

b) Për emërimin e anëtarëve të KQV-ve, KZQV-ja bashkëpunon dhe njofton strukturat lokale të partive politike që kanë të emëruar anëtarët e tyre në KZQV, për të sjellë propozimet përkatëse për

anëtarët e KQV-ve.

## Neni 2 **Përbërja e KQV-ve**

KQV-ja është organ kolegjal. Ajo formohet dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, sipas mënyrës së mëposhtme:

1. Qendrat e votimit të bashkisë/komunës radhiten sipas numrit të zgjedhësve, duke filluar nga qendra me numrin më të madh të zgjedhësve deri tek ajo me numrin më të vogël të zgjedhësve. Radhitja e qendrave të votimit sipas numrit të zgjedhësve do të bëhet në KQZ.

2. Në bazë të shortit të hedhur në KQZ:

- Të gjitha qendrat e votimit me numër tek në radhë do të kenë kryetarin e KQV-së, nga e njëjta parti politike që ka propozuar zv/kryetarin në KZQV-në e bashkisë/komunës përkatëse.

- Të gjitha qendrat e votimit me numër çift në radhë do të kenë kryetarin e KQV-së, nga e njëjta parti politike që ka propozuar kryetarin e KZQV-së në bashkinë apo komunën përkatëse.

3. Në rast të ndarjes së një qendre votimi në dy ose më shumë qendra votimi, atëherë kryetari/ët e qendrave të reja të votimit do të jenë të të njëjtës parti politike me atë të kryetarit të qendrës së votimit, nga e cila u nda/në qendrat e reja të votimit.

## Neni 3 **Propozimet për anëtarët e KQV-ve**

1. Për qendrat e votimit për të cilat forca politike (PS ose PD), në bazë të shortit dhe nenit 2 të këtij udhëzimi ka të drejtën e propozimit të kryetarit të KQV-së, ajo do të sjellë propozimet për 3 (tre) anëtarë të KQV-së dhe cili prej tyre do të jetë kryetar i KQV-së. Për qendrat e tjera të votimit, ajo do të sjellë propozimet për 2 (dy) anëtarë të KQV-së dhe cili prej tyre do të jetë zv/kryetar i KQV-së.

2. Partia politike që ka propozuar zv/kryetarin në KQV-të e bashkisë/komunës përkatëse, i lind e drejta të bëjë edhe propozimin e sekretarit për çdo qendër votimi të kësaj bashkie/komune.

3. Partia Socialdemokrate ka të drejtën e propozimit të 1 (një) anëtari për çdo KQV të bashkisë/komunës përkatëse.

4. Partia Republikane e Shqipërisë ka të drejtën e propozimit të 1 (një) anëtari për çdo KQV të bashkisë/komunës përkatëse.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi bazën e shortit të hedhur do të dërgojë në KZQV:

- Numrat e qendrave të votimit, për të cilat Partia Socialiste do të ketë kryetarin e KQV-së, kurse Partia Demokratike të zv/kryetarit të KQV-së.

- Numrat e qendrave të votimit, për të cilat Partia Demokratike do të ketë kryetarin e KQV-së, kurse Partia Socialiste të zv/kryetarit të KQV-së.

## Neni 4 **Kriteret për emërimin e anëtarëve të KQV-ve**

Anëtarët e KQV-së duhet të plotësojnë këto kriterë;

1. Nuk mund të jenë deputetë, kandidatë për në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore.

2. Nuk mund të jenë anëtarë të një KQV-je tjetër.

3. Nuk mund të jenë ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror.

4. Nuk mund të jenë anëtarë të KQV-së, personat të cilët, për shkak të detyrës, janë të pajisur me armë.

5. Nuk duhet të jenë dënuar për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Duhet të jenë me vendbanim dhe vendqëndrim të regjistruar, brenda bashkisë/komunës përkatëse.

7. Të propozohen nga partitë politike përkatëse, jo më vonë se 15 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

#### Neni 5

KZQV-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve, kryetarit, zv/kryetarit dhe sekretarit të çdo qendre votimi, mbi bazën e propozimit të partive politike të përcaktuara në nenin 3 të këtij udhëzimi dhe sipas modelit A25, të miratuar nga KQZ-ja.

Sekretari ka statusin e anëtarit pa të drejtë vote në KQV.

#### Neni 6

Anëtarët e KQV-së emërohen vetëm për periudhën e zgjedhjeve dhe në çdo rast emërimi i tyre duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve.

#### Neni 7

Kur KZQV-ja konstaton se vendi i një anëtarit të KQV-së së kësaj bashkie/komune ngelet vakant për çfarëdolloj shkak, atëherë KZQV-ja i kërkon partisë politike përkatëse të sjellë propozimin për anëtarin e ri brenda 3 (tri) ditëve nga krijimi i vendit vakant apo marrja e njoftimit.

#### Neni 8

Kur anëtarit i KQV-së jep dorëheqjen ajo depozitohet pranë KQV-së, e cila e dërgon menjëherë në KZQV-në përkatëse. Në këtë rast KZQV-ja vepron si në rastin e nenit 7.

#### Neni 9

Kur vendi i anëtarit të KQV-së ngelet vakant ditën e votimit deri në shpalljen e rezultatit, njoftohet menjëherë KZQV-ja përkatëse, e cila pasi bën verifikimet merr vendim për deklarimin e vendit vakant. Më pas fillojnë procedurat për emërimin e anëtarit të ri të KQV-së. Në këtë rast, KZQV-ja menjëherë i kërkon partisë së cilës i mungon anëtarit i saj të bëjë menjëherë zëvendësimin. Të gjitha procedurat e mësipërme për plotësimin e vendit vakant, duhet të plotësohen brenda 6 orëve nga momenti i konstatimit të vendit vakant.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

### **U D H Ë Z I M** **Nr.8, datë 15.9.2003**

#### **MBI PROCEDURAT ANKIMORE-ADMINISTRATIVE TË VENDIMEVE TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE TË QEVERISJES VENDORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e tij të datës 15.9.2003, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi Kryetar  
Dodë Prenga Anëtar  
Klement Zguri Anëtar  
Dëshira Subashi Anëtar  
Pandeli Varfi Anëtar  
Maksim Shimani Anëtar

në mbështetje të pjesës së dymbëdhjetë, kreut I, nenet 146 e në vijim, të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

**U D H Ë Z O N:**

Neni 1  
**Qëllimi i udhëzimit**

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e procedurave që do të ndiqen për marrjen, shqyrtimin, kalimin në mbledhje dhe marrjen e vendimit nga KQZ-ja të ankesave administrative të komisioneve zgjedhore.

PJESA E PARË  
**REGJISTRIMI DHE SELEKSIONIMI I ANKESAVE**

Neni 2  
**Depozitimi i ankimit**

Kundër vendimeve të KZQV-ve mund të bëhet ankim brenda 48 orëve nga data e shpalljes së vendimit. Ankimi depozitohet në zyrën e protokollit të KQZ-së.

Neni 3  
**Regjistrimi i ankimit**

Me paraqitjen e ankesës në KQZ, ajo duhet të regjistrohet menjëherë në regjistrin e ankesave, i cili është i vlefshëm vetëm për zgjedhjet në proces dhe duhet të përmbajë:

1. numrin rendor të ankimit;
2. datën dhe orën e paraqitjes së ankimit;
3. subjektin e ankimit;
4. objektin e ankimit;
5. numrin dhe llojet e dokumenteve që i bashkëngjiten ankimit.

Pas bërjes së shënimeve në regjistër, subjekti që ankohet merr nga KQZ-ja një vërtetim, i cili provon dorëzimin dhe marrjen e ankimit.

PJESA E DYTË  
**VERIFIKIMI PARAPRAK, FORMAL I ANKESAVE**

Neni 4  
**Përmbajtja e ankimeve zgjedhore**

Ankimet zgjedhore kundër vendimeve të KZQV-së duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme:

1. Emrin e plotë të subjektit zgjedhor ankues dhe adresën e tij;
2. Referimin e vendimit që ankimohet;
3. Përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar;
4. Të dhënat për faktet ose rrethanat, si dhe burimin e tyre;
5. Datën dhe firmën e ankimuesit;

Ankimet zgjedhore kundër vendimeve të KZQV-së mund të përmbajnë edhe faktet apo dokumentet mbi të cilat ai mbështet ankimin.

Me paraqitjen e ankimeve zgjedhore në sekretarinë e KQZ-së bëhet menjëherë seleksionimi i tyre në bazë të KZQV-ve.

Neni 5  
**Verifikimi i formës së kërkesës ankimore**

Drejtoria juridike bën verifikimim paraprak të kërkesës ankimore si më poshtë:

Kontrollon nëse kërkesa përmban:

- a) emrin e plotë të subjektit zgjedhor ankues dhe adresën e tij;
- b) referimin të vendimit që ankimohet;
- c) përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar, të dhëna për faktet ose rrethanat, si dhe

burimin e tyre;

ç) datën dhe firmën e ankuesit.

Në rast se kërkesa i përmban të gjitha elementet e mësipërme, ajo kalohet menjëherë në mbledhjen e KQZ-së për të vazhduar me hedhjen e shortit.

Në rast se kërkesa gjykohet se nuk i plotëson elementet e kërkuara, atëherë Drejtoria juridike e kalon atë të shoqëruar me një relacion në mbledhjen më të afërt të KQZ-së.

KQZ merr vendim për ankesën, për shqyrtim apo për plotësim nga ankuesi.

## PJESA E TRETË VENDIMI I NDËRMJETËM

Neni 6

### **Verifikimi nga anëtari i KQZ-së (relatori)**

Nëse kërkesa ankimore është pranuar nga KQZ-ja si e rregullt nga ana formale, atëherë një prej anëtarëve të KQZ-së i caktuar me short, bën verifikimin e kërkesës ankimore në lidhje me elementet e përcaktuara më poshtë:

1. kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit;
2. legjitimitetin e ankuesit;
3. respektimin e afateve ligjore për ankimin;

Ky verifikim dhe relatimi në KQZ i kërkesës apo kërkesave ankimore duhet të kryhet brenda 24 orëve nga momenti i depozitimit të kërkesës.

Neni 7

### **Marrja e vendimit të KQZ-së**

KQZ merr vendim të ndërmjetëm:

1. Për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore në seancë publike, pasi dëgjon relatorin e çështjes brenda 24 orëve nga fillimi i shqyrtimit të çështjes.
2. Për bashkimin e ankimeve të së njëjtës KZQV kur çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre lehtëson zhvillimin e gjykimit, i cili është i formës së prerë.

Neni 8

### **Shpallja e vendimit**

Vendimi i KQZ-së për pranim shpallet publikisht, si dhe tregon ditën, orën për shqyrtimin e çështjes në seancë publike.

Neni 9

### **Caktimi i seancës për shqyrtimin në themel të kërkesës**

Seanca për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore duhet të caktohet jo më parë se 24 orë nga shpallja e vendimit për pranimin e ankimit.

## PJESA E KATËRT SEANCA E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS APO KËRKESAVE ANKIMORE

Neni 10

### **Parime të përgjithshme**

1. Shqyrtimi i çështjes është publik.
2. Shqyrtimi i çështjes përpara KQZ-së bëhet verbalisht.
3. Shpjegimet dhe pretendimet e palëve rreth çështjes parashtrihen me shkrim.
4. Palët kanë të drejtë të dëgjojnë dhe përfaqësohen për pretendimet e tyre.

#### Neni 11

##### **Palët dhe përfaqësuesit e tyre**

1. KQZ ngarkon një punonjës të saj me detyrën e sekretarit të posaçëm për shqyrtimin në seancë plenare të ankimeve.
2. Në ditën dhe orën e caktuar palët ose përfaqësuesit e tyre njoftojnë sekretarin për praninë e tyre.
3. Përpara se të fillojë seanca, sekretari fton palët ose përfaqësuesit e tyre të zënë vendet e caktuara.
4. Nëse në ditën dhe orën e caktuar njëra ose të dyja palët nuk paraqiten, seanca zhvillohet pavarësisht pjesëmarrjes së tyre.
5. Sekretari mban procesverbalin e seancës plenare të ankimit.

#### Neni 12

##### **Drejtimi i seancës**

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve drejton seancën.

#### Neni 13

##### **Fazat e shqyrtimit të çështjes**

Shqyrtimi i çështjes përfshin 3 faza, si më poshtë:

1. administrimi dhe pranimi i provave;
2. shqyrtimi dhe rivlerësimi i tyre;
3. marrja e vendimit përfundimtar në lidhje me çështjen.

#### Neni 14

##### **Faza e parë**

##### **Administrimi dhe pranimi i provave**

1. KQZ fton dhe lejon palët të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e tyre, duke paraqitur në shqyrtim vetëm ato prova që janë të domosdoshme dhe që kanë lidhje me objektin e gjykimit.
2. Në rastet kur nga palët paraqiten prova që nuk kanë lidhje me shqyrtimin e çështjes, atëherë KQZ-ja merr vendim të ndërmjetëm për mospranimin e tyre në seancë.
3. Në fillim dëgjohet pala që ka paraqitur ankesën dhe pastaj pala kundër të cilës bëhet ankimi.

#### Neni 15

##### **Faza e dytë**

##### **Shqyrtimi i provave**

1. Procesi i shqyrtimit të provave ka të bëjë me verifikimin e të gjitha dokumenteve apo fakteve të paraqitura, nga palët në proces.
2. KQZ-ja ka të drejtë të saktësojë objektin e çështjes në shqyrtim dhe bazën ligjore, si dhe të kërkojë prova kryesisht.

#### Neni 16

##### **Rivlerësimi i votave**

1. Gjatë shqyrtimit të ankimit zgjedhor, KQZ-ja kryen verifikimin e dokumentacionit zgjedhor, si dhe rivlerësimin e votave kur këto çmohen të nevojshme prej saj.
2. Kur gjatë shqyrtimit të ankimit zgjedhor KQZ-ja urdhëron rivlerësimin e votave të kontestuar, ky i fundit bëhet në prani të palëve të interesuara dhe publikut.
3. Në këtë rast KQZ-ja, me vendim, cakton dhe shpall orën e zhvillimit të seancës për

rivlerësimin e votave.

Neni 17  
**Faza e tretë**

**Marrja e vendimit përfundimtar**

1. KQZ-ja merr vendim përfundimtar në lidhje me ankimin zgjedhor brenda tri ditëve nga data e regjistrimit të ankimit.
2. Për ato ankime që kthehen nga KQZ-ja për plotësime, afati fillon nga data e dorëzimit të ankimit të plotësuar.
3. Çdo vendim i KQZ-së mund të ankimohet pranë Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, brenda dy ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 18  
**Elementet e vendimit**

Vendimi i KQZ-së duhet të përmbajë këto elemente:

1. Vendimi i KQZ-së është gjithmonë i formës së shkruar.
2. Nënshkruhet nga Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KQZ-së.
3. U drejtohet palëve të interesuara.
4. Shpjegojnë faktet në të cilat është bazuar nxjerrja e vendimit.
5. Tregojnë bazën ligjore të vendimit.
6. Mundësinë e palëve për ta ankimuar në rrugë gjyqësore, si dhe tregon afatet për ta bërë këtë.
7. Përmbajnë bashkëngjitur mendimin e pakicës ose arsyetimin paralel, të nënshkruar nga anëtarët që e mbështesin atë.

Neni 19  
**Llojet e vendimeve të KQZ-së**

KQZ-ja merr vendimet e mëposhtme për ankimet zgjedhore:

1. lë në fuqi vendimin e KQZV-së;
2. ndryshon vendimin e KQZV-së;
3. deklaron pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe vendos përsëritjen e tyre, sipas nenit 117 të Kodit Zgjedhor.

Neni 20  
**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**U D H Ë Z I M**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE NR.1, DATË 11.7.2003 "MBI PROCEDURAT E RISHIKIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE 2003", NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN NR.2, DATË 25.7.2003**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2003, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi Kryetar  
Dodë Prenga Anëtar  
Tomor Malaj Anëtar

Pandeli VarfiAnëtar  
Klement ZguriAnëtar  
Igli ToskaAnëtar  
Maksim ShimaniAnëtar

në mbështetje të nenit 29/1,6, nenit 31/1, nenit 44/2 dhe nenit 58 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

#### U D H Ë Z O N:

Në udhëzimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1, datë 11.7.2003 "Mbi procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2003", ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 25.7.2003, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 6, në pjesën III.dh) "Zgjedhësi është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit", paragrafi 2/ii bëhet:

ii. Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesaur:

- kërkesë me shkrim ku të jetë/në shënuar zgjedhësi/sit që pretendohet se nuk është/janë në qendrën e duhur të votimit dhe qendra e votimit ku pretendohet të jetë/në.

Në rast se nuk ka kërkesë personale të zgjedhësit për të ndryshuar qendrën e votimit, KZQV-ja, i dërgon zyrës së gjendjes civile përkatëse të dhënat e zgjedhësit/ve për të përcaktuar vendbanimin e zgjedhësit/ve.

2. Në pikën 6, në pjesën III.e) "Zgjedhësi nuk është në listën paraprake të qendrës së votimit të vendbanimit të tij", paragrafi i/3 bëhet:

"Në rastin kur zgjedhësi paraqet për dokument indentifikimi letërnjoftimin, pasaportën ose kartën e zgjedhësit, ai duhet të paraqesë një certifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile të njësisë përkatëse, jo më vonë se tre muaj nga data e paraqitjes së saj."

3. Në pikën 6, në pjesën III.e) "Zgjedhësi nuk është në listën paraprake të qendrës së votimit të vendbanimit të tij", pika "3. Shqyrtimi i kërkesës dhe marrja e vendimit", paragrafi ii/1 bëhet:

"Në rast se grupi i verifikimit gjen zgjedhësin, ai duhet t'i marrë atij një deklaratë, nëse dëshiron të votojë në qendrën përkatëse të votimit të njësisë zgjedhore. Deklarata është sipas modelit të miratuar nga KQZ dhe kundërfirmohet dhe nga anëtarët e grupit të verifikimit.

- Nëse zgjedhësi deklaron se nuk dëshiron të votojë në këtë njësi, KZQV-ja përkatëse merr vendim për rrëzimin e kërkesës.

- Nëse zgjedhësi deklaron se dëshiron të votojë në qendrën përkatëse të votimit të njësisë zgjedhore, KZQV-ja merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin I pika (iii) të udhëzimit të KQZ-së nr.1, datë 11.7.2003."

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

#### V E N D I M

**Nr.168, datë 3.9.2003**

#### PËR DHËNIE LICENCE

PËR RADIO VENDORE PRIVATE

"SHQIP"

SUBJEKTIT: "ANTENA" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

#### V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "Antena" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve

radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sefedin Çela

**V E N D I M**  
**Nr.169, datë 3.9.2003**

**PËR DHËNIE LICENCE**

PËR RADIO VENDORE PRIVATE  
"RADIO+3"  
SUBJEKTIT: "RADIO+3" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "Radio+3" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Fierit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sefedin Çela

**V E N D I M**  
**Nr.170, datë 3.9.2003**

**PËR DHËNIE LICENCE**

PËR RADIO VENDORE PRIVATE  
"REAL"  
SUBJEKTIT: "REAL TV" SHA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "Real TV" sha., me vendndodhje në qytetin e Durrësit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve

radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sefedin Çela

**V E N D I M**  
**Nr.171, datë 3.9.2003**

**PËR DHËNIE LICENCE**

PËR RADIO VENDORE PRIVATE  
"ALDO-03 FM"  
SUBJEKTIT: "ALDO 03" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "Aldo-03" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sefedin Çela

**V E N D I M**  
**Nr.172, datë 3.9.2003**

**PËR DHËNIE LICENCE**

PËR RADIO VENDORE PRIVATE  
"EURO STAR MUSIC"  
SUBJEKTIT: "EURO STAR MUSIC" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "Euro Star Music" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data

e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sefedin Çela

**V E N D I M**  
**Nr.173, datë 3.9.2003**

**PËR DHËNIE LICENCE**

PËR RADIO VENDORE PRIVATE  
"NEW PLANET"  
SUBJEKTIT: "NEW PLANET RADIO" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "New Planet Radio" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sefedin Çela

**V E N D I M**  
**Nr.174, datë 3.9.2003**

**PËR DHËNIE LICENCE**

PËR RADIO VENDORE PRIVATE  
"HOUSE OF ARTS"  
SUBJEKTIT: "HOUSE OF ARTS RADIOTELEVIZION" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore,

zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sefedin Çela

## V E N D I M ( I S H K U R T U A R )

Gjykata e Shkallës së Parë të Kavajës, me vendimin nr.140, datë 4.4.2003, vendosi shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Jazi Uku, i datëlindjes 29.5.1966.

## KËRKESË

Fiqirete Banaj e datëlindjes 1964, me banim në Patos kërkon të shpallet i zhdukur ose i vdekur bashkëshorti i saj, Selam Banaj.

KËRKUESE  
Fiqirete Banaj

## NDREQJE GABIMI

Në ligjin nr.9125, datë 29.7.2003 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 12.3.1999 botuar në Fletoren Zyrtare nr.72-2003 bëhen këto ndreqje:

|                                                                                                                      |                                                                                                       |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Në nenin 20 pika 1<br>Është:<br>me vendim të Këshillit të Ministrave në kontratën kolektive ose individuale të punës | Bëhet:<br>me vendim të Këshillit të Ministrave,<br>në kontratën kolektive ose individuale të punës,   |
| Në nenin 21<br>Është:<br>me vendim të Këshillit të Ministrave<br>në kontratën kolektive ose individuale të punës.”.  | Bëhet:<br>me vendim të Këshillit të Ministrave,<br>në kontratën kolektive ose individuale të punës.”. |
| Në nenin 63<br>Është:<br>Titulli i Kreut VII                                                                         | Bëhet:<br>Titulli i Kreut XVII                                                                        |
| Në nenin 74, neni 197/3, që është shtuar, pika 2 rreshti i fundit                                                    |                                                                                                       |
| Është:                                                                                                               | Bëhet:                                                                                                |

|                            |                            |
|----------------------------|----------------------------|
| detyrimin tërësor të pagës | detyrimin absolut të pages |
|----------------------------|----------------------------|

Në nenin 46 pika 5, pas fjalës "pushohen" duhet hequr presja dhe fjalët "si dhe".

Në pikën 6, rreshti 3 vendoset një presje para fjalës "dëmshpërblim i cili i shtohet pagës".

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

|                                                                                                  |                                                                                                                           |                                                                                                                                                       |                                                                                                      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kodi Penal</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve<br/>Zyrtare</i><br><br>Mars, 2002 | <b>Kodi i<br/>Procedurës<br/>Penale</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve<br/>Zyrtare</i><br><br>Shtator, 2002 | <b>Kodi i<br/>Procedurës<br/>Civile</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve<br/>Zyrtare</i><br><br>Korrik, 2002                              | <b>Kodi Rrugor</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve<br/>Zyrtare</i><br><br>Qershor, 2002 |
|                                                                                                  | <b>Kodi Penal<br/>Ushtarak</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve<br/>Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002            | <b>Përmbledhëse<br/>legjislacioni<br/>në fushën<br/>e Përmbarimit</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve<br/>Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 |                                                                                                      |

Doli nga shtypi më 23.9.2003

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë